

K R I T I K Ë E B I B L I O G R A F I

PALOK DAKA

KONTRIBUT PËR BIBLIOGRAFINË E GJUHËSISË
SHQIPTARE (III)

— 1905 - 1909 —

— 1905 —

366. — ADAMIDI, Dr. : Aperçu général . . . Shih Nr. 312 (1904)
367. — ARBER, G. : Etudes Linguistiques et Etymologiques. Mots dérivés des racines albanaises *Kri* et *Bri* [Studime gjuhësore dhe etimologjike. Fjalë të prejardhuna nga rranjët shqipe *Kri* dhe *Bri*].—*BESA, Le Caire Janar-Shkurt 1905, Vit'i I, Nr. 4-5, fq. 75-78.*
Etimologji. Nga fjala *Kri* (krye, kokë) autori mendon se burojnë fjalët *Krispi* (familje italo-arbëneshë), (mbreti) *Kreora* (mbretnesha) *Kreisa*, etj.
368. — ASDREN (Pseud. i *Aleksandër S. Drenova*): Cheshtja e alfabetit. — *ALBANIA, London 1905, Vit'i 9, Nr. 4, fq. 76-80.*
Jepet një pasqyrë e përgjithëshme e alfabeteve që u përdorën për shkrimin e gjuhës shqipe. Ma poshtë A. shkruen se për gjuhën shqipe nevojitet një alfabet me shkronja latine, tue gjetë si ma të përshtatshëm alf. e Shoq. "Bashkimi".
369. — ATEDHETARI, X. (Pseudonim): Il Congresso Nazionale Albanese di Bucarest [Kongresi Kombëtar Shqiptar i Bukureshtit]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania) Romë, 1 Majë 1905, Vieta II, Nr. IX (16), fq. 113-114.*
Kongresi Kombëtar Shqiptar, që u mbajt me 23 prill 1905 në Bukuresht, mori vendimin që të adoptohet një ortografi (alfabet) e përbashkët për gjithë Shqipinë.
370. — CHESHTIA e Abése. — *ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9, Nr. 12, fq. 235-236.*
Shkruhet se ka ardhun koha t'u jepet fund bisedimeve për çeshtjen e alfabetit. Propozohet të pranohet pa ba bisedime alf. i shoq. "Bashkimi", mbi të cilin mund të diskutohet për ndreqjen e të metave, etj.
371. — (DOK SULA) (Pseud. i *Aleksandër Xhucanit*) : Mendimë mbi chestjën'e "E"-se / Te hécura nga gne lëtre / . — *ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9, Nr. 8, fq. 162-163.* —
Çeshtje të ortografisë. Autori vren se në gazetata e Shkodrës shkruenjë p.sh. *knnoj, msoj, knnojtor, mleth*, etj. pa "ë", kurse shkencërisht ato duhen shkruar me "ë": *kënnoj, mësoj*, etj.
372. — DOK SULA (Pseud. i *Aleksandër Xhuv nit*): Per thémelim te gne ghubë létraré- — *ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9, Nr. 11, fq. 217-221.*
Autori mendon se dialekti i jugut do të jetë baza e gjuhës letrare shqipe. Ma poshtë tregohen arësytet pse pikërisht toskëni-

shtja do të bahet bazë e gjuhës letrare shqipe. Në tri pika A. formulon parimet, të cilat, simbas tij, do të shërbejnë për krijimin e gjuhës letrare shqipe

373. — FRASÉ popullore t Maltsiis s' Shkodres. — *ALBANIA, London 1905, Vit'i 9, Nr. 7, fq. 112.*

Botohen disa përshëndetje të mbledhuna në Malcinë e Veriut (p.sh. në rrugë: *Ndesha e mirë. Mir se çjen. A jee, burrë, si jee?* etj. tue hy mbrendë, tue pi raki, tue hangër bukë, kur çohet sofrat; ndesha në kuvende, në punë, etj.).

374. — GRAMMATICUS (Pseudonim): Testi e teste (Questioni ortografiche) [Tekste e krena (Çeshtje ortografie)]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania), Romë 15 mars 1905, Vite II, Nr. VI (13), fq. 96.*

Kritikë librit me titull "Kendime per shkollë te para te Shcypenies", botue në Vjenë (1904). Preken edhe çeshtje të alfabetit dhe të ortografisë.

375. — IL DIZIONARIO di Kristoforidh [Fjalori i Kristoforidhit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 marzo 1905, Anno IX, Nr. 5, fq. 5.*

Artikullit mbi Kristoforidhin dhe fjalorin e tij, të botuem në *Bulletin d'Orient* të Athinës, nën drejtimin e A. Andréadës, Red. e *La Naz. Alb.* i ban disa vërejtje me karakter biobibliografik.

376. — JAKOVA (Gaspër): Iliri, Epiroti, Macedoni. . Shih Nr. 330 (1904)

377. — JAKOVA (Gaspër): L'Albania. Geografia fisica e statistica etnografica commerciale [Shqipëria. Gjeografia fizike dhe statistika etnografike tregëtare]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania) Romë, 15 Fruer 1905, Vite II, Nr. IV (11) fq. 74-77; Nr. V (12). fq. 83-87; Nr. VI (13). fq. 90-93.*—

Përmban edhe disa etimologji toponimesh.

378. — JAKOVA (Gaspër): Fillët e Shcypetarevé. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania), Romë 1 Cershuer 1905, Vite II, Nr. XI (18), fq. 131-132; Nr. XII (19), fq. 142-143; vv.*

Jepen edhe disa etimologji (simbas teorisë pellazgjike) për emna përëndishë mitologjike e vendesh (toponimesh). —

379. — K[ONICA], F[AIK]: Fjalet shkencë ne ghuhe t'one. — *ALBANIA, London 1905, Vit'i 9, Nr. 4, fq. 84-86.*

Botohet një listë prej 54 termash të gjeometrisë dhe të algjebërës në gjuhën frange, të pregatitun nga Kr. Dako, me qëllim që të gjënden fjalët shqipe përkatësisht për termat frange. Ma poshtë Konica shkruen se rrugët për pasunimin e leksikut të shqipes janë tri, të cilat A. i parashtron në këtë artikull.

380. — K[ONICA], F[AIK]: Per thémëlim te gne ghuhé lëtravé. — *ALBANIA, London 1905, Vit'i 9, Nr. 6, fq. 123-125.*

Pikëpamjen e vet në lidhje me problemin e gjuhës letrare të shqipes, A. e formulon në katër pika, të cilat i zhvillon gjatë këtij artikulli.

381. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — *ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9 Nr. 7, fq. 137.*

Mbi prejardhjen e fjalës *lahutë* (ital. *liuto*, provan. *laut*, frangj. vj. *leüt*, frangj. e re *luth*) si dhe të fjalës *hungare* (hungarisht: *gusle*), të cilat në shqip tregojnë një instrument të vetëm.

382. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — *ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9, Nr. 8, fq. 153-154.*

Leksik. Polemikë me Shahin Kolonjën rreth kuptimit të fjalës *lahutë*. Ma poshtë boton një listë me emna veglash muzikore që njihen në Shqipëri, të cilat A. i ndan në instrumenta ere (fryme), gjalmë dhe goditjeje.

383. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — *ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9 Nr. 10 fq. 185.*

Çeshtje ortografie. Shkruhet se shkrimtarët e moçëm të veriut "ë"-n e përdornin ma shumë se gegët e sotëm. Për ilustrim A. sjell një citat të P. Bogdanit nga *Cuneus Prophetarum* (1685).

384. — [KONICA, FAIK]: Facia e Drëctorit. — *ALBANIA, London 1905, Vit'i 9 Nr. 11, fq. 209-210.*

1. Mbi kuptimin dhe prejardhjen e fjalës *kushtrim* (nga "kush asht trim");

2. Mbi bibliografinë shqipe të viteve 1902-1903 të H. Pederseinit (shënohen 36 vepra, shkrime dhe fletore të shtypuna shqip a në gjuhë të huej përmbi Shqipërinë) (Shih edhe versionin frangjisht fq. 224)

3. Mbi librin rumanisht "*Viitorul Romanismului in Balkani*" scrisoare deschisa de N.N.Nacio, presidente te Societatei Albaneze DRITA, fa. 80. ku bahet fjalë për historinë e shoq. DRITA në Bukuresht, themelimin e gaz. SHQIPETARI etj. (Shih edhe versionin frangj., fq. 224).

4. Njoftim mbi largimin e At Pashko Bardhit nga detyra e mësuesit të shkollës shqipe në Borgo Erico (Dalmaci) dhe zavendësimin e tij me At Shtjefen Gjeçovin.

385. — LAHUTA e Malcisi. Disa shënime të shkrimit shqip. — *DRITA, Sofia Vjeshtë e tretë, 1905, Vit IV, Nr. 69, fq. 2-3 e v.*

Komentohet vepra "Lahuta e Malcisë" e Gj. Fishtës. Në artikull flitet gjatë për disa çeshtje të ortografisë së të dy dialekteve kryesore të shqipes. (Në këtë numër si dhe në disa numra të mavo-nshëm, ribotohen pjesë nga "Lahuta" në të dy dialektet: gegë-nisht e toskënisht, me shënime gjuhësore) (Shkrue me alf. e "Stambollit").

386. — LAMBI, PETRO: Dy lëtra / Çeshtja e alfabetit / — *ALBANIA, London, 1905 Vit'i 9, Nr. 10, fq. 201.*

Propozohet të bahet një mbledhje e përgjithëshme për vendosjen e një alfabeti të pranueshëm për të gjithë. Personalisht A. pëlqen ma tepër alf. e "Stambollit". Në një shënim të vetin, F. Konica shkruen se për arsye të ndryshme nuk mund të bahen mbledhjet që propozohen, po ma mirë asht të pranohet nga të gjithë alfabeti i shoq. "Bashkimi".

387. — LLAMBI, PETRO: Fjalëtor i Kristoforidhit. — *DRITA, Sofia, 22 Prill 1905, Vit IV, Nr. 60, fq. 2.*

Jepet një biografi e shkurtën e Kristoforidhit. Flitet për randësinë e fjalorit (i cili u mbajt i fshehun për ma se 30 vjet) dhe shërbimin e madh që kjo vepër i ka sjellun gjuhës shqipe. (Shkrue me alf. e "Stambollit")

388. — SLAMBI (sic! LLAMBI), PETRO: Il vocabolario di Kristoforidhi [Fjalori i Kristoforidhit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Giugno 1905, Anno, IX, Num. 11, fq. 4-5.*

Ribotim (i përkthym në italisht) i artikullit të botuem në DRITA (shih Nr. 387).

389. — LE LIVRE d'un Albanais [Libri i një Shqiptari]. — *L'ALBANIE, Bruxelles, Mai 1905, 6me Année, Nr. 2 fq. 5.*

Marrim vesh, shkruhet në këtë njoftim, se bashkatdhetari

ynë zotni A. N. Parthenis, i cili nënshkruen me pseudonimin letrar *de Ary René d'Yvermont*, do të botojë së shpejti një vëllim me interes të naltë letrar e filologjik mbi Shqipërinë.

390. — LEK GRUDA (Pseud. *i Luigj Gurakuqit*): Vjershërimi n'gjuhë shqype . . . Shih Nr. 333 (1904).
391. — LEK GRUDA (Pseud. *i Luigj Gurakuqit*): Disa Viërsha te Hiéronyme De Rades mé shenimé. — ALBANIA, London 1905, Vit'i 9, Nr. 1 fq. 22-24; Nr. 2, fq. 42-45; Nr. 8 fq. 156.
Botohen disa copa letrare nga veprat e De Radës me komente dhe shënime gjuhësore të autcrit.
392. — LEK GRUDA (Pseud. *i Luigj Gurakuqit*): Albania e Shocenia é Bashkimit. Thé-mélimi i gjuhës létraré. — ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9, Nr. 2, fq. 47-50.
Pranimin e alfabetit të "Bashkimit" nga ana e *Albania-s* A. e konsideron si një fakt me të cilin çeshtja e alfabetit të shqipes mund të thuhet se asht zgjidhun. Ma poshtë A. shkruen edhe për çeshtje të ortografisë, si premisë me randësi për themelimin e gjuhës letrare shqipe. Fton të mblidhen të gjithë nën flamurin e *Albania-s* dhe të "Bashkimit" për të shpejtue punën e theme li. mit të gjuhës letrare shqipe.
393. — LEK GRUDA (Pseud. *i Luigj Gurakuqit*): Ghuha é Shkéntsavé. — ALBANIA London, 1905, Vit'i 9, Nr. 8, fq. 158-161.
Tue iu përgjigjun thirrjes së Kr. Dakos (shih Nr. 410), autori bri terminologjisë frange rrjeshton termat shqipe, të sajueme prej tij, të cilat i propozon të futen në terminologjinë shqipe. Ma poshtë A. parashton metodën që ai ka ndjekun në krijimin e këtyne ter-mave.
394. — LEK GRUDA (Pseud. *i Luigj Gurakuqit*): Per thémélim te gne gjuhé létraré. — ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9, Nr. 12, fq. 230-235.
A. vë në dukje ndryshimin dhe zhvillimin që ka ba gjuha e folun në gojën e popullit (dialektet). Fjala *gjuhë*, që i përgjigjet greqishtes *glossa*, shkruen se ka ndjekun në kohë e vende të ndryshme këtë evolucion: *gluhë, gljuhë, gjuhë, guhë*. Shembuj të këtij evolucioni sjell edhe për fjalët *kjaj (qaj) gjatë, zgjedh, gjas, qumësht, qoftë; gjavdër, kjarë, bijë, goja, gjobë*. Nga gjithë këto ndryshime, që vrehen në gjuhë, A. pyetjes se cila trajtë asht ma e drejtë dhe cila duhet të zgjidhet në themel të gjuhës letrare, i përgjigjet se pa ba hetime dhe diskutime të përbashkëta mbi këtë fushë nuk mund të thuhet gja e saktë. Ma poshtë A. në vija të përgjithëshme tregon rrugët e pasunimit të leksikut të shqipes.
395. — [LETËR e Naum Veqilharxhit]. — DRITA, Sofje, 22 gusht 1905, Vit'i IV, Nr. 65, fq. 1-2.
Ribotëhet i plotë në gjuhën greke teksti i letrës që Naum Veqilharxhi i dergoi nga Bukureshti nipit të vet në Vjenë më 1846. Kjo letër, thuhet në shënimin e redaksisë, u gjet në bibliotekën e ministrit të arësimit, në Sofje.
396. — LUMO SKENDO (Pseud. *i Mit'hat Frashërit*): Fjeshhtësia është bukuri e një gjuhe — KALENDAR I KOMBIAR, Sofje, 1905, Mol'i nëntë, fq. 45-47.
Pikla ortoepie e ortografie në shqipet. (Shkruen me alf. e "Stambollit").
397. — NJË FAQE nga libr'e Pietrë Budit. Shqip shkruarë më 1664. — KALENDAR I KOMBIAR, Sofje, 1905, Mol'i nëntë, fq. 40-43.

- Flitet për veprën *Dotrina Cristiana* e R. Bellarmino, kthye në shqip prej P. Budit. Riprodhohen dy faqe nga krejt i parë i kësaj vepre, (shkrue me alfabetin e "Stambollit")
398. — NOTES [Shënim]. — *ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9, Nr. 5, fq. 104.*
Njoftohet se H. Pedersen ka botue në revistën gjermane *Romanischer Jahresbericht* bibliografinë shqipe për vjetet 1899-1901.
399. — NOTES [Shënim]. — *ALBANIA, London 1905, Vit'i 9, Nr. 9, fq. 183.*
Njoftohet se Holger Pedersen botoi në koleksionin e *Mémoires de l'Académie Royale des Sciences et des Lettres de Danemark* (6^e série, 1905) një studim mbi përemnat dëftorë të armenishtes së vjetër. Në këtë studim, thuhet, gjindet edhe një digresion interesant mbi disa përemna të shqipes.
400. — NOTIZIA Storica [Lajm historik]. — *LA QUESTIONE ALBANESE, Buenos Aires, Maggio 1905 Anno, I, Nr. 4, fq. 16.*
Përmban edhe antroponime (emna familjesh arbëneshe të Italisë, në krahinë e Ururit).
401. — P.:Shkaku i të mos mbrothësuarit të shkronjave shqipe në Shqipëri. — *KALENDARI KOMBIAR, Sofje 1905, Mot'i nëntë, fq. 49-61.*
Simbas autorit, një nga shkaqet që ka pengue zhvillimin dhe përparimin e gjuhës shqipe., asht edhe prania e disa alfabeteve për shqipen. Propozohet të përdoret vetëm alfabeti i shoq. së "Stambollit" (Shkrue me alf. e "Stambollit").
402. — PERMI shkrim te fjales "NA". — *ALBANIA, London, 1905, Vit'i 9, Nr. 1, fq. 24-25.*
Artikull mbi trajtën e shkurtë të përemnave vetorë dhe ortografi. (Përdorim i gabuem i përemnit vetor të vetës së parë shumë *na*, në trajtën e apostrofue *n'a*).
403. — PERMI émerat ci mbarojne më E — *ALBANIA, London, 1905, Vit.'i 9, Nr. 5, fq. 100-101.*
Çeshtje të morfologjisë. Disa vërejtje mbi nyjen në gjuhën shqipe.
404. PROFESOR per ghuën Shqipe ne Univërsitet t'Belgradit. — *ALBANIA, Belgrad, 6 Septembrie 1905, moti IV, Nr. 41, fq. (4).*
Njoftohet se këtë vjet shkollor në Universitet të Beogradit do të hapet një katedër për gjuhën shqipe, me titullar z. George Meksi.
405. — SCHNEIDER, ED.: "Fondazione di Roma. Origine pelasgo-albanese del mito di Romolo e Remo" — [Themelimi i Romës. Origjina pellazgo-shqiptare e mitit të Romulit e Remit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Cutanzaro) Italia, 31 Gennaio 1905, Anno IX, Nr. 2, fq. 4-5.*
Letër (në frangjisht) që Ed. Shnajder i dergon drejtorit të kësaj reviste A. Lorekjos në lidhje me deshifrimin e disa mbishkrimeve etruske me anën e shqipes. Ma poshtë A. Lorekjo në një shënim të vetin i ban disa vërejtje zëbërthimeve etimologjike të Shnajderit.
406. — SHKODERANI, X.: Questioni politiche e grammaticali [Çeshtje politike e gramatikore]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania), Romë, 1 korrik 1905, Vieta II, Nr. XIII (20), fq. 145-146.*
Njoftohet se në Kongresin Kombëtar të Shqipëtarëve, që u mbajt në Bukuresht, muerën pjesë si përfaqësues mbi 2000 shqiptarë (toskë e gegë) njerëz të ditun e të kulturës. Në këtë kongres u muer vendim që të pushohet çdo luftë alfabetesh dhe të adoptohet një sistem i vetëm si bazë e njësimimit gramatikor e letrar të shqipes.

407. — SHKOLLA shqip-rumanisht në Kostancë. — *DRITA, Sofia 15 Shën-Andre 1905, Vit IV, Nr. 71' fq. 2.*

Njoftohet se në Kostancë (Rumani) u hap një shkollë nate për punëtorët shqiptarë të atjeshëm. Për drejtimin e shkollës u themelue një këshillë prej 17 vetash me emnin "Lumina" ("Drita"). Kryetar i këshillit u zgjodh Dr. Ibrahim Temo, drejtor i shkollës Z. Bicioia, profesorë për gjuhën shqipe ZZ. Llazo dhe Aleksandri; për gjuhën rumune Z. Zaharia Zanfir, shqiptar nga Shkupi, etj (Shkrue me alf e "Stambollit")

408. — [SHOQERIA "Dialeria Shqiptare"]. — *ALBANIA, Belgrade, 11 Februaire 1905, Moti IV, Nr. 37, fq (3-4).*

Kronikë mbi ceremoninë e zhvillueme me rastin e themelimit të Shoqnisë "Dialeria Shqiptare" në Braila (Rumani).

409. — SOCIETÀ Albanese in Braila (Romania) [Shoqni Shqiptare në Braille (Rumani)]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Gennaio 1905, Anno IX, Nr. 2, fq. 5-6.*

Njoftohet se me 25 Dhjetor 1904, u themelue Shoqnia "Dialeria Shqiptare", nën kryesinë e z. Kr. Dako. Ma poshtë jepet kronika e konferencës, që u mbajt po atë ditë.

410. — TE BERET é Fjalëvë. / Bashkekerkim J. — *ALBANIA, London, 1905, Vit' i 9, Nr. 11, fq. 222-223.*

Kristo Dako shpall një konkurs për krijimin e fjalëve të reja shqipe, tue premtue për konkuresin ma të mirë një çmim prej 100 frangash. Ma poshtë botohen disa kriterere udhëzuese për formimin e fjalëve shqipe.

411. — TE PREEMET e Kuvëndit Kombetar te Shecypenies ne Bukurëshe. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania), Romë, 1 Majë 1905, Vieta II, Nr. IX (16), fq. 114.*

Shpallen vendimet e Kuvendit Kombëtar të Bukureshtit (prej 25 pikash). Ndër të tjera thuhet edhe:

1. Të krijohet një komitet qendror drejtues me emnin *Kombi*.
2. Organi zyrtar i këtij komiteti të jetë *Laimtari i Shcypenies*; i cili do të botojë edhe një shtesë vetëm në shqip, me titull *Kombi*.
3. Si alfabet dhe ortografi e përbashkët për gjuhën shqipe do të adoptohet ai i *Gramatikës Shqipe* të Prof. G. Jakova-Merturi, etj. (Shih po aty edhe versionin italisht: *Decisioni del Congresso Nazionale Albanese di Bucarest*).

412. — UNE particularité phonétique du dialecte tosque [Një veçori fonetike e toskënishtes]. — *ALBANIA, London, 1905, Vit' i 9 Nr. 1 fq. 29-30.*

Autori konstaton se në toskënishtet shquhen tri lloj *e-sh*: *e* e mbyllët (fermé), *e* e shurdhët (muet) dhe *e* e shurdhët e dobët.

413. — UN principe Imperiale di Germania studente di lingua albanese [Një princ perandorak i Gjermanisë student i gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Novembre 1905 Anno IX, Num. 22, fq. 5-6.*

Njoftohet se djali i kaizerit Guljelm të Prusisë, princi Ajte] (Eitel), i asht vu mësimit të shqipes nën drejtimin e prof. Kurt Hassert, i Universitetit të Kolonjës (Cöln). Ma poshtë flitet

për disa udhëtime për qëllime shkencore që Prof. K. Hassert pat ba në malet e Shqipërisë së Epërme. (Kjo informatë asht nxjerrë nga gaz. *Albanija* e Beogradit, dt. 9 nandor).

444. — VDEKJET e motit 1904. — *KALENDARI KOMBIAR, Sofje 1905, Mot'i nëntë fq. 8-29, 30-31.*

1. Njoftohet se nga fundi i vjetit 1903 vdiq Emile Legrand. Jepet një përmbledhje e shkurtën e jetës dhe e veprave të Legrandit Ilustrohet edhe me një fotografi.

2. Njoftohet se me 5 qershor 1904 vdiq Sami Frashëri. Jepet një përmbledhje e shkurtën e jetës dhe e veprave të S. Frasherit. Ilustrohet edhe me një fotografi. (Shkrue me alf. e "Stambollit")

445. — VORF DUKAGJINI (Pseud. i *Pashko Bardhit*): Ghuha e Shcyptarvé t'Arbnëshvé — *ALBANIA, London 1905, vit'i 9, Nr. 2, fq. 35-36.*

Dialektologji. Riprodhohen dy copa të *Ungjillit të Sh'Lukës XV. 11-32* në të folmen e shqiptarëve të Borgo Ericos (Dalmaci) të pajisuna nga autori me 45 shënime leksikore e gramatikore. Këto dy copa t'Ungjillit, shkruhet, i pat botue në dialekte të ndryshme të gjuhës shqipe edhe Gustav Majeri në gramatikë të vet.

446. — X (Pseudonim): Dy létra. / Çeshtje te alfabetit /. — *ALBANIA, London 1905, Vit'i 9, Nr. 10, fq. 199-200.*

Shpjegohen arësytet pse Shoq. "Bashkimi" u mund nga shoq. "Agimi" e Ndre Mjedës. Propozohet të mblidhet një kuvend në Trieste, në Rumani ose në ndonjë vend tjetër për të vendosë një herë e mirë çeshtjen e alfabetit të shqipes, në bazë të alfabetit latin.

— 1906 —

447. — ALFABETAT e Shcyptarve. — *KALENDARI I SHOCNISE "DIJA" (Vjenë), 1906 fq.3-4.*

Shkruhet për damin e madh që i ka sjell zhvillimit të gjuhës shqipe prania e katër alfabeteve të ndryshme; propozohet që të merret një vendim për adoptimin e një alfabeti të vetëm, etj. Ma poshtë botohet alfabeti i shoq. "Bashkimi" dhe "Agimi", tue vue në dukje se këto dy alfabete, 19 shkronja i kanë të përbashkëta dhe 14 të ndryshme.

448. — CASTRENSIS (Pseud. i *Aleksandër Xhuvanit*): Permi thémëlim te gni gjuhë létraré shcipé. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Ottobre 1906, Anno, X, Nr, 20, fq. 4-5.*

Në trajtimin e problemit të gjuhës letrare të shqipes, autori arrinë në përfundimin se zhvillimi i lirë i të dy dialekteve të shqipes dhe njohja reciproke e tyre, mund t'i çojnë këto dialekte drejt një pike të përbashkët.

449. — CHESTJA e ghuhes. — *KOMBI, Boston (USA) 19 September 1906, Mot'i pare, vol I, Nr. 11, fq. 1.*

Diskutohet përmbi artikullin e botuem për çeshtje të gjuhës në Nr. 9 të kësaj gazete. Shkruhet se me punët e gjuhës duhet të merren njerëz të ditun, glosologët; shtrohet si nevojë e dorës së parë bashkimi i alfabeteve, pastrimi i gjuhës shqipe nga fjalët e hueja etj.

420. — DOK SULA (Pseud. i *Aleksandër Xhuvanit*): Cheshtia e Abése. — *ALBANIA, London 1906, Vit'i 10, Nr. 1, fq. 19.*

Shih Nr. 448, 451, 452.

421. — DOK SULA (Pseud. i Aleksandër Xhuvanit): Lëtre Përm Fjalën "Kombiar". Noti Drëjtor. — ALBANIA, London 1906, Vit'i 10 Nr. 6, fq. 125-126.

Tue diskutue për kuptimin e përdorimin e disa mbrapashtesave adjektive të shqipes (khs.: -të, -ak, -ag, -ac, -acak, -uk, -ush; -tar, -ar, -tor (a -tuer), -or, (a -uer); -ik, -es, -ash, -osh) Autori shkruen se në shqipet mbrapashtesë -iar nuk ka. Si pasojë A. trajtën "kombiar" e gjen te parregullshme. Në vend të saj mund të shkruhet: "kombar", "kombëtar" ose "kemtar". Ma poshtë A. prek edhe problemin e fjalëve të hueja, fjalë të cilat po përdoren pa nevojë në gjuhën shqipe etj.

422. — DOK SULA (Pseud. i Aleksandër Xhuvanit): Prëjardhja e pjësavët te Fjalës ng ghuhet Shcipe. *Kushtumune X. L. Grudes.* — ALBANIA, London 1906, Vit'i 10 Nr. 7, fq. 139-142; Nr. 8, fq. 155-157; Nr. 9, fq. 171-172; 1907, Vit'i 11, Nr. 1, fq. 11; Nr. 3, fq. 55-56; Nr. 4, fq. 77-79.

Studim monografik me këtë përmbajtje (nëntitujt simbas autorit): 1. Substantivet: substantivat bëhen: 1) Nga substantivët 2) Nga Adjektivët, 3) Nga Verbet dhe 4) Nga ch'do tjetre pjese të Fjales. Në këtë studim autori parashtron rregullat e përgjithëshme të formimit të substantivave nga pjesët e ndryshme të ligjeratës, me anë të mbrapashtesave. Studimi ilustron me shembuj dhe shënime e vërejtje të ndryshme gjuhësore.

423. — GNA dy fjale latine, te perdoruna në ch'do ghuhe. — ALBANIA, London 1906, Vit'i 10 Nr. 3, fq. 42-43.

Jepet kuptimi në shqip i disa shprehjeve latine, me përdorim ndërkombëtar si *Ab antiquo*, *Casus belli*, *Modus vivendi*, *Statu quo* e *Statu quo ante bellum*.

424. — HARALLAMBI, PAPA KRISTO: Konstandin Kristoforidhi. — KALENDARI KOMBIAR Sofje 1906, Mot'i dhjettë, fq. 43-46.

Artikull mbi jetën dhe veprat e Kristoforidhit, shkruet nga autori në Negovan me 12 janar 1905 (botohet mbas vdekjes). Tue përfundue A. shpreh dëshirën që Fjalori i Kristoforidhit të botohet edhe me shkronja shqipe dhe me shpjegimin shqip, në mënyrë që nga ky fjalor të përlitohet gjithë shqiptarët. (Shkruet me alf. e "Stambollit")

425. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — ALBANIA, London 1906, Vit'i 10, Nr. 3, fq. 41.

1. Për fjalën "i humbur", A. shkruen se asht një albanizëm; që ka kuptimin "i humbur nga mendja" (frangj. sot, idiot dhe jo me kuptimin frangj. perdu).

2. Jepet kuptimi i pasthirmës "O burrani!" (Shih edhe versionin frangjisht: *Notes*, fq. 56).

426. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — ALBANIA, London 1906, Vit'i 10, Nr. 4; fq. 57-61.

Jepen të përmbledhun këto shënime:

1. Fjala latine *viridis*, që do të thotë ngjyrë bari, në shqip hyni me kuptim tjetër: *i, e verdhë*, kurse fjala latine *galbinus*, që do të thotë e verdhë, ngjyrë dylli (fr. jaune), në shqip u ba *i gjelbërt* (ngjyrë bari).

2. Recension i shkurtën botimit "Abetar i Vogel" shecyp, mas abévët t'Bashkimit e t'Stambollit, me tregime n't'dy dhialektet? prej Lek Grudës.

3. Shkruen për përparimin dhe në favor të alfabetit të "Bashkimit" dhe kundër alfabetit të "Stambollit". Shkruen për krijimin e fjalës *qkëshëroj*, simbas analogjisë me fjalën angleze *to outreach* (të hedhunit e njeriut jashtë gjimit të kishës) për t'u përdorur në vend të fjalëve ekskomunikoj a aforis.

427. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — *ALBANIA, London, 1906, Vit'i 10, Nr. 5, fq. 83.*

Njoftohet se At Shtjefen Gjeçovi, i cili zavendësoi për disa muej At Pashko Bardhin në drejtimin e shkollës shqipe të Borgo Ericos, u largue për në Shkodër. Drejtor i ri i kësaj shkolle shkoi Dom Gjergj Koleci.

428. — [KONICA, FAIK]: Ch'eshite gne "Kryefjale?". — *ALBANIA, London, 1906 Vit'i 10, Nr. 5, f. 89-91.*

Jepet kuptimi dhe përdorimi i fjalës "Kryefjalë" për frangj-devise, ital. motto.

429. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — *Albania, London 1906, Vit'i 10, Nr. 6, fq. 114.*

Njoftohet se Dr. H. Pedersen botoi *Bibliografinë për vjetin 1904*, në të cilën përfshihen 24 vepra shqipe dhe mbi Shqipërinë (Shih edhe versionin frangjisht, fq. 248).

430. — [KONICA, FAIK]: Themeli i ch'do përparimi, ëdhtë Cheshtia e abëse. *Dedëkuar Xotit Sotir Pétsi.* — *ALBANIA, London 1906, Vit'i 10, Nr. 6, fq. 119-124.*

Pikëpamja e autorit për çeshtjen e alfabetit të shqipes anon. në favor të allabetit të Shoq. "Bashkimi".

431. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — *ALBANIA, London, 1906, Vit'i 10, Nr. 9, fq. 170-171.*

Disa vërejtje mbi emnat mashkullorë me prejardhje turke, të cilat kur shquhen në tosk. marrin njëjën -u dhe në geg. -a (Khs. tosk. *Ali-u, Kadi-u, Velë-u*, etj. geg. *Ali-a, Kadi-ja, Velë-ja*, etj.)

432. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — *ALBANIA, London, 1906, Vit'i 10, N. 10-11-12, faq. 186.*

Ambigjenit. Simbas autorit emnat mashkullorë të sendeve të pashpirtë ose të paqena (abstrakte), në shumës kthehen e bahen femnorë, pra: *male të bukura, zakone të mira, mendime të thella*, etj. dhe jo: *male "të bukura", zakone "të mirë" mendime "të thellë"*, etj.

433. — LIBRA SHQIP: Leksikon tis Alvanikis glossis (Fjalëtor'e gjuhësë shqip) prej Kostandin Hristoforidhit, shtypurë n'Athinë 1904. Shtypshkronja Saqellaridhi; një tome, i math me 80, me 502 faqe. — *KALENDARI KOMBINAR, Sofje, 1906, Mot'i dhjetë, fq. 23.*

Bibliografi. Ky fjalor, i cili ka afro 10.000 fjalë, asht ma i miri i këtij lloji që ka dalë deri më sot, thuhet në këtë artikull. E meta e këtij fjalori, veç që disa fjalë nuk janë shpjegue mirë, asht se shpjegimi i fjalëve bahet greqisht dhe me shkronja greke asht shkruet edhe pjesa shqipe. (Shkruet me alf. e "Stambollit").

434. — LEK GRUDA (Pseud. i *Luigj Gurakuqit*): Vjershenimi n'ghûbe shecpe. Shih Nr. 338 (1904).

435. — LORECCHIO, ANSELMO: Per il Collegio italo-albanese di Sant'Adriano [Për Kolegjin italo-shqiptar të Shën Adrianit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagoro (Catanzaro) Italia, 15 Giugno 1906, Anno X, Nr. 11, fq. 1-3; Nr. 13, fq. 3-5.*

- Në këtë artikull kundërshtohen disa reforma të qeverisë italiane që cenojnë autonominë e këtij instituti.
436. — MAZZIOTTI, Prof. G.: Monografia del Colleggio Italo-Greco [Monografi e Kolegjit Italo-Grek]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Gennaio 1906, Anno X, Nr. 1, fq. 2, 11; Nr. 2, fq. 2, 11; Nr. 16, fq. 1-2; Nr. 17, fq. 5-8; Nr. 18, fq. 1-4.*
- Jepet historiku i Kolegjit Italo-Grek të themeluar në San Benedetto Ullano, për shqiptarët e Italisë, në vjetin 1733, nën kujdesin e Papës Klementi i XI, me origjinë shqiptare. Në vjetin 1794, shkruhet, ky kolegji u transferue në Shën Adrian të Shën Dhimitër Koronës.
437. — SHOCERIE T Kombetarë. — *ALBANIA, London, 1906, Vit'i 10, Nr. 6, fq. 127.*
- Njoftohet se në Shqipëri u themelue një Shoqni me emrin "Marësia" (Mbarësia), me program: përhapja dhe mësimi i gjuhës shqipe, kudo ku ka shqiptarë. Ma poshtë botohet thurja e kësaj shoqnie për një alfabet të vetëm.
438. — SKROGNAT e Kombit. — *KOMBI, Boston (USA) June 23, 1906, Mot'i parë, vol. 2, Nr. 2, fq. 2.*
- Mungesa e një alfabeti të vetëm shkruhet në këtë artikull, po e pengon mjaft zhvillimin e përparimin e gjuhës shqipe. Ma poshtë thuhet se ky organ për arësye praktike zgjodhi për shkrimin e veta alfabetin e shoq. "Bashkimi", megjithëse ky alfabet nuk asht pa të meta.
439. — VILA, NURI: Guha Shep. — *KOMBI, Boston (USA) 19 September 1906, Mot' i parë, Vol. I, Nr. 11, fq. 1-4.*
- Ndër të tjera A. shkruen se kur në shqipet mungojnë fjalët për të shprehun një nocion a diçka tjetër, duhet të merren nga gjuhët e hueja, tue pasë parasysh që fjalët e hueja në shqip të kenë një trajtë shkrimi për të gjithë.
440. — VORF SHCYPETARI (Pseudonim): Pasyre é vishtire é giuhs Shcype. — *SHPNESA E SHCYPENIIS (Nada Albanije. La Speranza dell'Albania), Ragusa I. XII. 1906, Moti i II, Nr. 11, fq. 1.*
- Artikull mbi pastrimin e shqipes nga fjalët e hueja sllave; turke, greke, italiane, etj.
- 1 9 0 7 —
441. — ABECEJA j'one. — *DASAMIRI, Trieste, 14. XI. 1907, Mot'i I, Nr. 1, fq. 4.*
- Botohet një pasqyrë e alfabetit të shqipes (alf. i "Bashkimit"). me ndryshimet e variantit të alf. të "Agimit".
442. — ABECEJA Shqip. — *SHQIPERIA, Sofje 1 Mars 1907, Vit'i parë, Nr. 1, fq. 8.*
- Botohet një pasqyrë e alfabetit të shqipes (si dhe një pasqyrzë me shkronjat e bashkueme të variantit të "Bashkimit" dhe të Stambollit").
443. — ALFABETI. — *PELLASGU, Kajro (Egjypt) 1 Mars 1907, Vit'i I, Nr. 1, fq. 2.*
- Në mungesë të shkronjave të alfabetit të "Stambollit", Red. njofton se në këtë organ do të përdorë alfabetin latin (variantin e "Bashkimit"). Riprodhohet një pasqyrë e këtij alfabeti, me versionin frangjisht.
444. — ASDREN (Pseud. i Aleksandër S. Drenova): Shqiptarët e Konstancës. — *DRITA, Sofia, 26 shkurt 1907, Vit'i VI, Nr. 88, fq. 3.*
- Artikull për shkollën e natës në gjuhën shqipe për punëtorët e Konstancës (Rumani). (Shkrue me alf. e "Stambollit").

445. — **ATTIVITÀ Nazionale Albanese** [Veprimtari Kombëtare Shqiptare]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Marzo 1907, Anno XI, Nr. 5, fq. 5-6.*
Botohet në italisht thirrja e shoq. "Marësi" (Shih Nr. 437, 474)
446. — **ATTIVITÀ Nazionale Albanese** [Veprimtari Kombëtare Shqiptare]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Marzo 1907, Anno XI, Nr. 6, fq. 8-9.*
Njoftohet se në Bukuresht shoqnitë "Dituria", "Drita" dhe "Shpresa" u shkrinë në një shoqni të vetme me emnin "Bashkimi". Po këtu njoftohet edhe themelimi i shoq. shqiptare "Lidhja" në S. Louis Ms. (Amerikë) dhe i degës së Shoq. "Bashkimi" në Kostancë (Rumani).
447. — **BILOTA, Arciprete BERNARDO:** Opinione circa un adottabile comune Alfabeto per la coltura della Lingua Albanese [Mendim rreth adoptimit të një alfabeti të përbashkët për lavrimin e gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Maggio 1907, Anno XI, Nr. 9, fq. 3-4.*
Kritikon sistemin alfabetik të De Radës. Propozon që alfabeti i përbashkët i shqipes duhet të ketë edhe disa shkronja greke. Në një shënim të sajën Red. mban rezervë për artikullin e Bilotës; tue mos u pajtue sidomos me kritikën që autori i ban alfabetit të De Radës. Nga ana tjetër Red. njofton se për mungesë shkronjash të posaçme nuk mund të botojë artikullin tjetër të Bilotës me titull: *Proposta di un Alfabeto adottabile dagli cultori della lingua Albanese.*
448. — **CASTRENSIS** (Pseud. i Aleksandër Xhuvanit): Châstia é Alfabetit. La questione dell'alfabeto. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Aprile 1907, Anno XI, Nr. 8, fq. 6.*
Botohet në shqip dhe italisht. Për përmbajtjen shih edhe Nr. 420, 451, 452.
449. — **CHESTJA é alfabetës.** — *KOMBI, Boston, Mass (USA) 18 April 1907, Mot'i parë, vol. II, Nr. 33, fq. 1.*
Simbas lajmeve të ardhuna nga Shqipnia e gjetkë, shkruhet në këtë artikull, së shpejti do të mbahet në Bukuresht një kongres, ku do të vendoset përfundimisht geshnja e alfabetit të shqipes. Në këtë kongres parashikohet të përfaqësohen të gjitha shoqnitë shqiptare.
- 450 — **CHESTJA é Alfabetit.** — *KOMBI, Boston, Mass (USA) 20 May 1907, Mot'i parë, vol. II, Nr. 39, fq. 2.*
Propozohen shtatë ndryshime (zavëndësim shkronjash) për t'i'u ba alfabetit të "Bashkimit".
451. — **DOK SULA** (Pseud. i Aleksandër Xhuvanit): Chastia e Abése. — *KOMBI Boston, Mass (USA) 16 May 1907, Mot'i parë, vol. II, Nr. 37, fq. 1; Nr. 38, fq. 1.*
A. shprehet në favor të tezës që shqipja asht një gjuhë indo-europiane. Në lidhje me alfabetet egzistuese të shqipes, pëlqen ma tepër alfabetin e Shoq. "Bashkimi", tue shpjegue edhe arsëyet e këtij pëlqimi. Autori mendon se alfabeti i "Bashkimit" praktikisht do të bahej ma i përshtatshëm në rast se do t'i baheshin edhe disa ndryshime, p.sh. shkronjat *c, x, xh, z, dxh* të zavëndësoheshin respektivisht me shkronjat *kj a q, z, zj, zh, dz.* (Shih edhe Nr. 420, 448, 452).

452. — DON(sic) SULA (Pseud. i Aleksandër Xhuvanit): Dy fjalë për abenë. — *SHQIPERIA, Magaga (Egjyptë) 15 Qershor 1907, Vit'i I, Nr. 5, fq. 23.*

Tue iu përgjegjun dy pyetjeve të gaz. *Shqipëria*: 1. Cila abë ju pëlqen? 2. Përse ju pëlqen kjo abë? (Shih Nr. 455), autori në një artikull të gjatë përgjigjet në favor të alfabetit të "Bashkimit" (Këto mendime janë shprehur edhe në artikujt me Nr. 420, 448, 451) (Shkrue me alf. e "Stambollit").

453. — DOK SULA (Pseud. i Aleksandër Xhuvanit): Prëjardhja e pjësavet te Fjales . . Shih Nr. 422 (1906).

454. — DUSHMANI (Pseudonim): Lufta e marre (?). — *KALENDARI I SHOCNISE "DIJA", Wien 1907, fq. 86-87.*

U bahet thirrje gjithë shqiptarëve të bashkohen për të zgjedhur një alfabet të përbashkët për shqipen.

455. — DY fjalë për abenë. — *SHQIPERIA, Kairo 15 Shkurt 1907, Vit'i I, Nr. 3 fq. 4.*

Me qëllim që të vendoset një alfabet i përbashkët për shqipen, Red. hap diskutimin e kësaj çështjeje me dy pyetje, drejtuë gjithë shqiptarëve: 1. Cila abë ju pëlqen? 2. Përse ju pëlqen kjo abë? Përgjigjet dhe diskutimet priten të botohen në këtë organ.

456. — DY fjalë për abenë. — *SHQIPERIA, Magaga (Egjyptë) 15 Qershor 1907, Vit'i I, Nr. 5, fq. 3-4.*

Në lidhje me dy pyetjet që iu drejtuene lexuesve (shih Nr. 455), Red. shkruen se i kanë ardhur mjaft përgjigje me përmbajtje e kërkesa të ndryshme, në bazë të të cilave nuk mund të jepet një gjykim i premë. Red. mendon se për këtë çështje duhet formulue një anketë e re me pyetjet: Cila nga abetë, e Shkodrës apo e "Stambollit", pëlqehet ma tepër. Kjo anketë duhet shpërnda e diskutue në të gjitha klubet dhe shoqnitë shqiptare. (Shkrue me alf. e "Stambollit")

457. — DY fjale për abenë. — *KOMBI, Boston, Mass (USA) 20 March 1907, Mot'i parë, Vol. II, Nr. 30, fq. 1.*

Riprodhohet artikulli i gaz. *Shqipëria* të Kairos (Shih Nr. 455) ku shtrohen dy pyetjet për çështjen e alfabetit. *Kombi* mendon se puna nuk zgjidhet në këtë mënyrë, sepse asnjëni nga të 4-5 alfabetet egzistuese nuk asht pa të meta. Simbas *Kombi*-t duhet të krijohet një alfabet i ri, i cili të jetë ma i mirë se gjithë të tjerët.

458. — INFORMAZIONI: Per l'insegnamento della lingua albanese in Italia [Për mësimin e gjuhës shqipe në Itali] — *LA NAZIONE ALBANESE, Palagorio (Catanzaro) Italia, 31 Gennaio 1907, Anno XI, Nr. 2, fq. 7.*

Njoftohet se Zef Skiròi, deri tash i ngarkuem me mësimin e shqipes në katedrën e gjuhës shqipe të Inst. Mbr. Oriental të Napolit, u emnue profesor titullar i kësaj katedre (Shih edhe Nr. 491)

459. — KOMNENI (Pseud. i Kolë Kamsit): Graziado Isaia Ascoli. — *ALBANIA, London 1907, Vit'i II, Nr. 4, fq. 79-80.*

Artikull përkujtimor me të dhana biografike me rastin e për-vjetorit të parë të vdekjes së gjuhëtarit të njohun italian G.I. Askoli. Ndër të tjera thuhet se Askoli ka qenë edhe një njohës i mirë i gjuhës shqipe. Në librin "Studi critici (frammenti albanesi)", Askoli ka shkruë edhe për gjuhën shqipe, tue dhanë edhe disa mendime të vetat.

460. — [KONICA, FAIK]: Flëta e Drëctorit. — *ALBANIA, London, 1907, Vit'i II, Nr. 2, fq. 26.*

Shkruen për trajtat i pa-armatisur, i pa-armatosur për mbiemnin i veçantë dhe për neologjizmin vetëtar.

- 461— [KONICA, FAIK]: Fléta e Drëctorit. — ALBANIA, London 1907, Vit'i 11, Nr. 4, fq. 73-76.

Shënime të ndryshme:

1. Për fjalën *ipeshkëv* (geg.) që i përgjigjet tosk. *peshkop*.
2. Për vështirësitë që hasin të huejt në mësimin e shqipes për shkak të nyjevet *i, e të*;
3. Për rasat në gjuhën shqipje, të cilat autori i redukton në tri (*nominativi* / emnorja /, *accusativi* / kallzorja / dhe *rasa oblike*)
4. Ortografi. Kritikë dhe ndreqje gabimesh.
5. Recension dhe kritikë librit "*Bësa a Féa é Shqipetarevët te vjeter*" prej A. Siljanit, Sofje, 1907 (78 faqe)" të cilën e konsideron si një vepër të dështueme dhe pa ndonjë vlerë shkencore.

462. — [KONICA, FAIK]: Fléta e Drëctorit. — ALBANIA, London 1907, Vit'i 11 Nr. 5, fq. 92.

Shënime të ndryshme *)

Bibliografi: 1. FIALOR I RII I SHCYPES, Perbâam préi Shocniët te Bashkimit, shtypur bukur dhe botuar në Shkodrë asht italisht e shqip, ka 538 face dhé gn'a 12.000 fjale dhé kushton vetem 4 fr. 75 me gith' poste". Rekomandohet ta ketë çdo shqiptar.

463. — KONGRESI i Shqipetarevé Zhon Turc. — ALBANIA, London 1907, Viti 11 Nr. 5, fq. 98-99.

Botohet ftesa e Klubit Shqiptar "Bashkimi" të Manastirit; dërgue F. Konicës, për të marrë pjesë në Kongresin e Manastirit; për të vendosun mbi alfabetin e shqipes si dhe përgjigja negative e F. Konicës.

464. — LIBRI e Kalëndare t'rii n'gjuh t'one. — SHIPNËSA E SHCYPENIIS (*Nada Albania. La Speranza dell'Albania*), Raguse 16.I.1907, Mot i III, Nr. 2, fq. 4.

Bibliografi: — "*Vargenimi n'gjuhe Shcype (me gni Fjalorth shcyp-frangisht — n'marim)*" prej Lek Grudës.

— "*Fjalorth Shcyp-Frangisht e Frangisht-Shcyp (i fjalevé t'rëja)*, prej L. Grudës. Bahet një koment i shkurtë.

— "*Abëtari i vogel shcyp*" mbas abëvét t'" Bashkimit, e t' "Stambollit", me regime n't'dy dialektet — prej Lek Grudes-

465. — ÑI štojce programit. — DASAMIRI, Trieste, 14.XI.1907, Mot'i I, Nr. 1 fq. 1

Një nga çeshtjet që po diskutohet sot, shkruhet në këtë artikull, asht edhe çeshtja e alfabetit të shqipes. Ma poshtë Red. njofton se në këtë organ do të përdorë alfabetin e shoq. "Agimi"; i cili, shkruhet, asht sot për sot ma i miri dhe ma i kuptueshme si për toskët ashtu edhe për gegët. (Shkrue me alf. e Shoq. "Agimi").

466. — PESIMISTI (Pseudonim): Kongrés i Abése. — ALBANIA, London, 1907, Vit'i 11, Nr. 5, fq. 93-94.

Njoftohet se me 1 Nandor do të mbahet në Manastir një kongres për çeshtjen e alfabetit të shqipes. Autori në këtë artikull mban qendrim mospajtues ndaj këtij kongresi.

*) Lajmet dhe përmbajtja e landës së rev. Albania të vjetit 1907, në të vërtetë i përkasin vjetit 1908. (SH. i A)

467. — SHOQERIA "BESA-BESËN" Boston Mass. (Amerike). — *DRITA, Sofia, 26 Shkurt 1907, Vit VI, Nr. 88, fq. 4.*

Njoftohet themelimi në Boston Mass. i shoq. shqiptare "Besë-Besën" me kryetar Fan Nolin. Botohet programi i punës së kësaj shoqnie. (Shkrue me alf. e "Stambollit")

468. — SHOQERIA "LIDHJA SHQIPETARE" (Liga Albanese). — *DRITA, Sofia 15 qershuer 1907, Vit VI, Nr. 90, fq. 3.*

Njoftohet se në Buenos Aires (Argjentinë) u themelue me 21 prill 1907 e para dhe e vetmja shoqni me emnin "Lidhja Shqipetare" me kryetar Zep Prifti. Ndër të tjera kjo shoqni ka për qëllim edhe përhapjen e mësimin e gjuhës shqipe. (Shkrue me alf. e shoq. "Stambollit")

469. — SKANDERI (Pseudonim): Alfabetat. — *KALENDARI I SHOCNISE "DIJA" Wien 1907, fq. 3.*

Në hymje shkruhet se qëllimi i kësaj shoqnie asht të mos përzihet me çeshtjen e alfabetit, e cila i ka sjellë një dam të madh atdheut. Ma poshtë kërkohet bashkëpunimi i gjithë shqiptarëve për një alfabet të përbashkët.

470. — SKYPTARE, Kendoni: — *DAŠAMIRI, Trieste, 29.XI.1907, Mot'i I, Nr. 2, fq. 1-2.*

Artikull i red. kushtue mbrojtjes së alfabetit të shoq. "Agimi".

471. — THIRRJE permi ghithe Shocerite ghuhetarë shkrojesit Shqipetare nezjërresit si éné bashke-punojesit é ghithe ditarévé e te perkoheshmévé Shcipe. — *KOMBI, Boston, Mass. (Usa), 20 March 1907, Mot'i pare, Vol. II, Nr. 30 fq. 1.*

Botohet thirrja e shoqnisë "Marësi" (themelue në janar 1907); në të cilën shtrohen këto pika: të botohen libra në gjuhën shqipe, po ma parë të zgjidhet një alfabet i pranueshëm për të gjithë (për këtë të hapet një diskutim në shtyp), të hartohet një fjalor dhe një gramatikë e gjuhës shqipe, etj. (Shih edhe Nr. 437, 445)

472. — ZADHËNJE. — *DRITA, Sofia 15 korrik 1907, Vit VI, Nr. 91, fq. 3.*

Njoftohet se në Shkodër u themelue një shoqni kombëtare me emnin "Lirija", e cila ka për qëllim, ndër të tjera, edhe përhapjen e mësimin e gjuhës shqipe. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

— 1908 —

473. — ABECEJA Shqip. — *LIRIJA, Selanik, 28 Korrik 1908, Mot'i parë, Nr. 3, fq. 4.*

Botohet një pasqyrë e alfabetit të shqipes (ai i shoq. së "Stambollit") me versionet frangjisht, turqisht, greqisht dhe bullgarisht.

474. — ABECEJA Shqip. — *KORÇA, Korçë 15 Shënëndre 1908, Vit'i I rë, Nr. 1, fq. 4.*

Botohet një pasqyrë e alfabetit të shqipes (ai i shoq. së "Stambollit") me versionin turqisht, greqisht dhe bullgarisht.

475. — ABECEJA Shqip. — *BESA-BASHKIM, Konstantinople, 31 Shënëndre 1908, Vit'i parë, Nr. 8, fq. 3.*

Botohet një pasqyrë e alfabetit të shqipes (ai i shoq. së "Stambollit"), me versionet frangjisht e turqisht dhe me nga një fjalë shembull.

- 476 — ABETAREJA Shqip. *BESA Konstantinople, 5 vjeshtë tretë, 1908, Vit'i parë, Nr. 1 fq. 1-2.*

Shkruhet kundër atyne që duen të prishin alfabetin e shqipes tue adoptue shkronjat e hueja greke, italiane, sllave e sidomos

tash së fundi edhe turke. Me shkronja turke, thuhet në këtë artikull nuk shkruhet mirë as vetë turqishtja e jo ma shqipja, e cila ka edhe 12 tinguj ma tepër. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

477. — "BESA E FEJA e Skipëtarëvet të vjetër". — *DAŠAMIRI, Trieste, 25.II.1908, Mot'i II, Nr. 4, fq. 3.*

Bibliografi dhe recension i shkur tën veprës së A. Siljanit (Shkrue me alf. e shoq. "Agimi").

479. — CADICAMO, Prof. G: Girolamo De Rada. Cenni Biografici e Letterari [Jeronim De Rada. Shënime biografike e letrare]. — *KOMBI Boston, Mass. (USA) February 14, 1908, Mot'i dyte, Vol. III, Nr. 74, fq. 1 (v)*

Të dhana biografike mbi jetën dhe veprat e De Radës, me këta-nëntituj (simbas tekstit): *La nascita, Famiglia Levitica. L'educazione letteraria nel collegio Italo-Albanese. Le Rapsodie, L'ispirazione del Milosao.*

480. — CHESTJA e Alfabetit. — *KOMBI, Boston, Mass. (USA) October 16, 1908 Mot'i trete, Vol. III, Nr. 105, fq. 1.*

Gazetës *Kombi* i ka ardhun një letër nga Korça, ku e këshillojnë të përdorë alfabetin e "Stambollit". *Kombi* përgjigjet se do të rrej këtë që ka (alf. e "Bashkimit") deri sa të merret një vendim i përgjithëshëm për një alfabet të përbashkët për të gjithë.

481. — Ç'FITUAME nga Kongres i Manastirit. — *LIRIJA, Selanik 22 vjesht'e 3-të, 1908; Mot'i parë, Nr. 17, fq. 1.*

Kryeartikull kushtue rezultateve të Kongresit të Manastirit për çeshtjen e alfabetit të shqipes. Në këtë Kongres, thuhet ma poshtë, u sigurue jo vetëm fitorja e alfabetit të shqipes, po edhe bashkimi i shqiptarëve. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

482. — DAKO, KRISTO, A.: Who are the Albanians? [Cilët janë Shqiptarët?]. — *KOMBI, Boston, Mass. (USA) June 12, 1908, Mot'i trete, Vol. III, Nr. 88, fq. 2-3.*

Konferencë e mbajtur në gjuhën angleze nga Kr. A. Dako në "Hope Chapel" (Boston, Mass.) përpara vendasve dhe shqiptarëve të atjeshëm. Pjesën ma të madhe të konferencës, autori ia kushton historisë së gjuhës shqipe ("The Albanian language").

483. — DIPLOM'ë pare per profesor ne ghuhen shcipe. — *KOMBI, Boston, Mass (USA) October 26, 1908, Mot'i tretë, Vol. III, Nr. 106, fq. 2.*

Flitet për një shkollë tregëtare të hapun në Korfuz, në të cilën mësohet edhe gjuha shqipe me mësuës të shqipes Leon D. Naçi, diplomue nga Universiteti i Athinës.

484. — DOK SULA (Pseud. i Aleksandër Xhuanit): Fjalor'i Kristoforidhit. — *KOMBI, Boston, Mass. (USA) March 27, 1908, Mot'i dyte, Vol. III, Nr. 80, fq. 1, Nr. 81, fq. 1.*

Shkruen për randësinë e fjalorit si dhe për mundin dhe përpjekjet që i kanë kushtue autorit për hartimin e kësaj vepre. Ma poshtë Xh. porositë bashkatdhetarët që ta vijojnë punën e nisun nga Kristoforidhi për mbledhjen e leksikut të shqipes, në mënyrë që në të ardhmen të botohet një fjalor tjetër edhe ma i plotë.

485. — [GJEÇOVI, AT SHTJEFEN]: Fjalori. — *DAŠAMIRI, Trieste, 6.VIII.1908, Mot'i parë, Nr. 6, fq. 1-2 (v).*

Në këtë artikull shkruhet se Fjalorit të Bardhit (1635), të Kristoforidhit, (1904), Fjalorthit të L. Grudës (1906) i shtohet

edhe Fjalori i ri i shoq. "Bashkimi" (1908). Për këta fjalorë jepen të dhana të plota. Ma poshtë flitet gjatë e gjanë për randësinë dhe dobinë që i sjellin fjalorët mësimi me themel të gjuhës shqipe. (Shkrue me alf. e shoq. "Agimi").

486. — GNE FJALOR i ri i Ghuhes Shcip. Botognes Shoceria "Bashkimi". — *KOMBI, Boston, Mass. (USA) June 19, 1908, Mot'i tretë, Vol. III, Nr. 89, fq. 1.*

Mbas Fjalorit të Kristoforidhit, shkruhet në këtë artikull; u falet shqiptarëve një tjetër fjalor, i cili nga shumë anë qëndron ma nalt se Fjalori i Kristoforidhit, sepse asht dy herë ma i pasun dhe shtypun me shkronja shqipe (latine). Ma poshtë bahet fjalë për fjalorin e Kristoforidhit, i cili u botue në 1.000 kopje, por qeveria greke, me qëllim që të mos bahet e njohun kjo vepër, vuni në qarkullim vetëm 300 copë, të tjerat i shpërndau nëpër zyrtarë vendas. Ftohen edhe shoqnitë tjera të ndjekin shembullin e shoq. "Bashkimi".

487. — GNE LIBR'ë ré: Bésa a Féa e Shcipetarevé te vjeter (Prej L. Siljanit, shtypur ne shtypshkroga "Mbrodhesia" Sofje, 78 faqe). — *KOMBI, Boston, Mass. (USA) February 28, 1908, Mot'i dyte, Vol. III, Nr. 78, fq. 3.*

Bibliografi. Recension i shkurtën veprës së L. Siljanit. Jepet edhe një përmbledhje e përmbajtjes së kësaj vepre, në të cilën trajtohen edhe disa etimologji simbas teorisë pellazgjike.

488. — KADIU, D. A. : Gne radhua i nevojshim per Shcipetaret. — *KOMBI, Boston, Mass. (USA) February 28, 1908, Mot'i dyte, vol. III, Nr. 76, fq. 1; Nr. 77, fq. 2-3; Nr. 78, fq. 2; Nr. 79, fq. 1; Nr. 88, fq. 2-3.*

Bibliografi. Botohet një listë bibliografike prej 310 tituj veprash autorësh të huej e shqiptarë që kanë shkruar mbi Shqipninë, Ballkanin, etj. me përmbajtje të ndryshme historike, gjuhësore letrare, fetare, diplomatike, politike etj. të kohëve të ndryshme. Rrjeshtimi i landës bahet në rend, alfabetik simbas autorit (nga shkronja A deri te Z) me këto të dhana: 1) autori, 2) titulli i veprës, 3) vendi dhe data e botimit. (Të dhanat shpeshherë nuk jepen të plota).

489. — KOKU-MEJ-SHA (Pseudonim): Shkolla Shcip nde Rumani. — *KOMBI, Boston, Mass. (USA) July 31, 1908, Mot'i trete, Vol. III, Nr. 95, fq. 1.*

Mësohet se në vjeshtë të këtij vjeti (1908) në Rumani do të gelen shkolla në gjuhën shqipe. Shqiptarët e Rumanisë, përfundon artikullshkruesi, këtë punë duhet ta kishin ba ç'prej kohësh.

490. — KONGRES'I Manastirit. — *LIRIJA, Selanik, 8 Vjesh'e 3-të, 1908, Mot'i parë, Nr. 15, q. 1-3.*

Botohen: 1) Thirrja e Klubit "Bashkim" të Manastirit për mbledhjen dhe qëllimin e kongresit, 2) programi i punimeve të kongresit, 3) emnat e delagatëve pjesëmarrës në kongres, 4) verbalet e mbledhjeve të nandë ditëve të punimeve të kongresit dhe të komisionit dhe 5) vendimi i komisionit mbi çështjen e alfabetit. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

491. — LA CATTEDRA di lingua albanese nel R. Istituto Orientale di Napoli [Katedra e gjuhës shqipe në Institutin Mbr. Oriental të Napolit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 (!) [30] Novembre 1908, Anno XII, Nr. 22, fq. 5.*

Njoftohet anullimi me dekret mbretnor i emnimit të Z.

Skiròit si profesor në katedrën e gjuhës shqipe të Inst. Oriental të Napolit (Shih edhe Nr. 458).

492. — LE SOCIETÀ degli Albanesi in Constantinopoli ed in Salonico [Shoqnitë e Shqiptarëve në Konstantinopol dhe në Selanik]. — *LA NAZIONE-ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Novembre 1908, Anno XII, Nr. 21, fq. 5-6.*

Nga Konstantinopoli shkruajnë: Klubi shqiptar i themeluar në këtë qytet u mblohd me 30 tetor për konkretizimin e programit që duhet të zbatohet në lidhje me përhapjen e gjuhës shqipe, krijimin e shkollave, etj.

493. — LIBRA Shqip. Në motin 1907 u shtypnë këto libra: — *KALENDARI KOMBIAR Sofje 1908, Mot'i dymbëdhjetë, fq. 25-28.*

Bibliografi. Ndër të tjera shënohen edhe këto:

1. *Besa a Fea e Shqiptarëve të vjetër* prej A. Siljanit.
2. *"Vargënim n'gjuhë shqype"* prej L. Gruda.
3. *"Fjalorth shqyp-frëngjisht e frëngjisht-shqyp i fjalëve t'reja"* prej L. Grudës.

Këtyne veprave u bahet edhe nga një recension i shkurtër. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

494. — MESIME shqip. — *BESA, Konstantinople, 27 vjeshtë të tretë, 1908, Viti I, Nr. 5, fq. 2.* Shpallet se në Sulltan Bajazid në shkollën "Haddikai Meshveret" (Turqi) jepen dy herë në javë mësim në gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e "Stambollit")

495. — NOSTRE CORRISPONDENZE [Korrespondencat tona]. — *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro) Italia 31 Ottobre 1908, Anno XII, Nr. 20, fq. 2.*

Guidera Trifonio i drejton një letër drejtorit të *La Naz. Alb.* në të cilën i shkruen, ndër të tjera, se ka ardhun koha që njerëzit ma të shquem të Shqipnisë të mblidhen në një kongres kombëtar për të vendosun: 1. bashkimin e alfabetit, 2. botimin e një gazete shqipe mbrenda në një qytet të Shqipnisë, etj. Si përgjigje Red. njofton se së shpejti do të mbahet në Manastir një kongres për alfabetin.

496. — PIESTARI (Pseudonim) Abécéia. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Ottobre 1908, Anno XII, Nr. 20, fq. 1-2.*

Flitet për iniciativën e shoq. "Bashkimi" për një diskutim të përgjithshëm në mes të shoqnive dhe organeve të shtypit shqiptar për vendosjen e një alfabeti të përbashkët; botohet telegrami i shoq. "Bashkimi" të Manastirit, në të cilin njoftohet se me 1 nandor 1908 do të mbahet kongresi i përgjithëshëm për çështjen e alfabetit të shqipes; propozohet që kongresi të mbahet në Elbasan, në Tiranë ose në Shkodër.

497. — SHENIM. — *LIRIJA, Selanik 22 Vjeshtë e 3-të, 1908, Mot'i parë, Nr. 17, fq. 2.* Botohet një pasqyrë e alf. të "Stambollit" me ndryshimet e reja që iu bane disa shkronjave (e, r, x) në Kongresin e Manastirit (Shkrue me alf. e "Stambollit").

498. — SHKEMBI (Pseudonim): Alfabetat a po sëmundja e quajtur alfabetitis. — *KALENDARI I SHOQENISË "DIJA", Wien 1908, Mot'i III, fq. 3-6.* Flitet për alfabetet e shumta që po qarkullojnë në një kohë dhe damin që i sjellin gjuhës shqipe. Autori propozon që të katër alfabetet kryesore (i Autorëve të Vjetër të Veriut, i Stambollit;

i Bashkimit dhe i Agimit) duhet të gjejnë një rrugë për një alfabet të përbashkët e të pranueshëm për të gjithë. (Shkrue me alf. e 'Stambollit').

499. — SHKOLLA Sheip. — *KOMBI, Boston, Mass (USA) August 28, 1908, Mot'i dyte Vol. III, Nr. 99, fq. 1; Nr. 100, fq. 1; Nr. 101, fq. 1.*

Diskutohet për probleme të arësimit, të librave dhe të shkollave në Shqipëri. Një vend të gjanë në këtë artikull i kushtohet edhe gështjes së alfabetit të shqipes. Propozohet të bahet një mbledhje me përfaqësuesit ma të shquem të Toskënisë e të Gegënisë për të zgjidhë një herë e mirë punën e alfabetit.

500. — SHKRONJATË shqip dhe shkronjat turqishte. — *BESA-BASHKIMI, Konstantinople, 31 Shënëndre 1908, Vit'i parë, Nr. 8, fq. 1.*

Në këtë artikull shkruhet kundër një grupi prej katër vetash, i cili ka shpallun një "shoqni" me program që gjuha shqipe të shkruhet me shkronja turqishte. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

501. — SHOCENIA Létrare "BASHKIMI". Vllaxenvët Shcypetare. Diftim. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Settembre 1908, Anno XII, Nr. 18, fq. 3-5.*

Me rastin e 10 vjetorit të themelimit të Shoq. "Bashkimi", kjo shoqni boton një deklaratë ku tregohet veprimtaria dhjetëvjeçare e kësaj shoqnie, programi, qëllimi, veprat e botueme me alfabetin e kësaj shoqnie (31 vepra), organet e ndryshme (21 gazeta e revista) që u shkruene me këtë alfabet. Ma në fund deklarohet se kjo shoqni asht gati menjëherë ta shtrrojë për diskutim të përgjithshëm alfabetin e vet dhe të bashkëpunojë me shoq. e "Stambollit" dhe të "Agimit" për hartimin e një alfabeti të përbashkët dhe të pranueshëm për të gjithë shqiptarët.

502. — SHTJERTIME gjuhet. — *DASAMIRI I RI, Trieste, 20.V.1908, Mot'i parë Nr 2, fq. 3.*

Komentohen pozitivisht artikujt e Dok Sulës (A. Xhuvanit) me titull "Shtjertime gjuhe", që u botuene në rev. *Albania*. Ma poshtë thuhet se mbareasa -onj në dëftoren e tashme të foljeve në toskënisht, që në gegënisht asht -oj, dikur këtë trajtë (-onj) e ka pasë edhe gegënishtja (siç provohet nga gramatika e Fr. Rossit). Sot kjo trajtë haset ende në katundet Krajë e Shestan. (Shkrue me alf. e shoq. "Agimi").

503. — TE 120 këpucë-grisurit e Selanikut. — *SHKOPI, Kairo (Egjypte) 15 Vjeshtë e 3-të 1908, Vit'i II, Nr. 4, fq. 2.*

Simbas disa gazetave greke, mësohet se në Selanik u mbledhën 120 shqiptarë grekomanë, të cilët, në kundërshtim me vendimin e Kongresit të Manastirit, kërkue qe gjuha shqipe të shkruhet me shkronja greke. Artikullshkruesi këtu mban qëndrim kritik të kundërt. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

504. — TRE ALFABETE e disa nën alfabete u'Shkodre. — *DRITA, Sofia, 1 Janar 1908, Vit'i VII, Nr. 95, fq. 2-3 (ev).*

Shkruhet për alfabetin e Autorëve të vjetër të Veriut, për alf. e "Bashkimit" dhe atë të "Agimit", tue vue në dukje të metat e secilit dhe tue përfundue se asnjëni prej tyre nuk asht i përsosun. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

505. — VARIA: Il Congresso albanese [Kongresi Shqiptar]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Dicembre 1908 Anno XII, Nr. 23, fq. 4.*

Artikull mbi punimet e Kongresit të Manastirit.

— 1909 —

506. — A. S.: Barabiti'ë gjuhës shqip me të tjerat. — *LIRIJA, Selanik 18, korrik 1909, Mot'i i dytë, Nr. 53, fq. 3.*
Në këtë artikull flitet për këto çeshtje: 1) se shqipja asht një gjuhë e lashtë e familjes indoeuropiane; 2) se shqipja gjatë historisë së saj mori shumë fjalë nga romakët, sllavët, turqit, etj. 3) se shumë fjalë të hueja (greke, sllave, italiane, etj) po hyjnë në shqipet nëpërmjet të njerëzve që kanë mësue në vende të hueja, 4) propozohet të mblidhen fjalët shqipe të panjohuna ende dhe të futen në përdorim; të krijohen fjalë të reja simbas rregullave dhe natyrës së gjuhës shqipe si dhe të mirren nga gjuhët e hueja ato fjalë, të cilat i mungojnë shqipes. (Shkrue me alf. e "Stambollit").
507. — A DO të kemi një të vetëm gjuhë literare shqip?. — *DITURIJA, Selanik, 1 Prill 1909, Mot'i parë, Nr. 4, fq. 49-51.*
Pyetjes se cili dialekt do të merret si bazë e gjuhës letrare shqipe, i përgjigjet Gj. Pekmezi, i cili mendon se mund të jetë e folmja e Shqipnisë së mesme, me kusht që ma parë të studjohet nga kompetentët kjo e folme pak e njohun dhe të botohen materiale folkloristike tue u ba sa ma i njohun visari popullor i kësaj treve. (Shkrue me alf. e "Stambollit").
508. — ABECEJA Shqip. — *ZGJIM I SHQIPËRISË, Janinë 17 Shën Endre 1909, Mot'i parë, Nr. 57, fq. 4.*
Botohet një pasqyrë e alfabetit të shqipes (ai i shoq. së "Stambollit") me versionin turqisht dhe me nga një fjalë shembull.
509. — ABECETE Shqipë Dhe ca Abécébajnes të rinj(?). — *RRUFEJA, Tubhar-Fayoum H. Egypte, Shkurt 1909, Mot'i I, Nr. 2, fq. 1.*
Tue çmue nga njena anë si një akt pozitiv vendim e Kongresit të Manastirit për çeshtjen e alfabetit të shqipes, nga ana tjetër në këtë artikull goditet ashpër mbledhja që u mbajt në Selanik, nën kryesinë e Josif Adhamidhit, në të cilën u diskutue dhe u kërkue që gjuha shqipe të shkruhet me shkronja greke.
510. — ABETË Shqipe. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) September 3, 1909, Mot'i parë, Vol. I, Nr. 23, fq. 1.*
Shkruhet se shumë kritika po i bahen Kongresit të Manastirit, i cili në vend të një alfabeti të vetëm, pëlqei dy alfabete. Ma poshtë, thuhet, se njëni prej këtyne dy alfabeteve (aludohet për alfabetin me shkronja latine) do të jetë alfabeti i vetëm i gjuhës shqipe.
511. — ALFABETI i ri. — *ELCIA I ZEMERS JEZU KRISCTIT, (Shkodër), Mars 1909, Pjesa II, Nr. III, fq. 37.*
Me qëllim që të arrihet sa ma parë bashkimi i toskëve dhe i gegëve, Red. ban të ditun se tue fillue nga ky numër heq dorë nga alfabeti i vjetër dhe pranon alfabetin e ri (variantin latin) të pëlqyem në Kongresin e Manastirit. (Jepet një pasqyrë e plotë e shkronjave të reja).
512. — ANDEJ Ketej. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) October 1, 1909, Mot'i parë, Vol. I, Nr. 27, fq. 3.*
Simbas gazetës turke *Tasfir-i-Efkar* të gjithë ata që kërkojnë të shkruhet shqipja me shkronjat latine janë të shitun. Shqiptarët — vijon gazeta turke — do të ndrojnë besën po të mos shkruajnë

shqipen me shkronja arabishte. *DIELLI*, mbas këtij lajmi pyet: Tani kush mund të thotë se shkronjat arabishte s'ishin vepra dhe intriga të zhon-turqve?

513. — BIBLIOGRAFI: *Grammatik der albanischen Sprache* (Shkronjëtor' e gjuhësë shqip) prej Dr. Pekmezi, Wien 1908, një volym 8^o, 429 faqe. — *DITURIA, Selanik, 1 Janar 1909, Mot'i parë, Nr. 1, fq. 16.*

Recension. Kjo vepër, thuhet, asht ma e mira e llojit të vet që ka dalë deri më sot. Autori ka ditun të përmbledhë gjithë ndryshimet që janë në gjuhën tonë (toskënisht, gegënisht dhe nëndialektet). (Shkrue me alf. "Stambollit")

514. — BIBLIOGRAFI: "*Reliquie e vestigi dell'antico ceppo glottico albanese* — Michele Marchianò, Napoli, 1908, 18 faqe". — *DITURIA, Selanik, 1 Shkurt 1909, Mot'i parë, Nr. 2, fq. 32.*

Recension. Në këtë vepërzë, shkruhet, analizohen 21 fjalë thrakishte, maqedonishte e ilirishte e vjetër, që autori ka gjetun në historitë e autorëve të lashtë. Këtu riprodhohen me shënimit përkatëse fjalët: *Vekos e bekos* (shqip: bukë), *Thamirios* (shqip: thà mirë), *Visi a besi* (shqip: besë, i besës), *Pelë* (shqip: pelë); *Emadhià* (shqip: e madhëja), *Maliis* (shqip: mal, malsi, malësor); *Aspetos* (shqip: i shpejtë), *Vrention a brention* (shqip: brirë; brine), *Kaston* (shqip: kashtë). (Shkrue me alf. e "Stambollit").

515. — ÇESHTJA e gjuhës Shqipe. — *BASHKIMI KOMBIT, Manastir 24 Dimëror 1909, Vit'i I, Nr. 16, fq. 1-2.*

Simbas një lajmi të fletores *Tyrk i Ri*, merret vesh se qeveria otomane ka kërkuë që gjuha shqipe të mësohet detyrimisht me shkronja turke. Në këtë artikull mbahet qëndrim kundër kësaj kërkesë. (Shkrue me alf. e "Stambollit")

516. — DAKO, KRISTAQ, A.: Kongres'i Elbasanit. — *BASHKIMI KOMBIT, Manastir, 10 vjesh'e Irë 1909, Vit'i I, Nr. 1, fq. 1.*

Artikull mbi Kongresin e Elbasanit. Botohen edhe vendimet e këtij Kongresi (prej 15 pikash). (Shkrue me alf. e "Stambollit").

517. — E PËRKOHËSHMJA "Albania" ë Londres. — *RRUFËJA, Tubhar-Fayoum, H. Egypte, Shtator 1909, Mot'i I, Nr. 9, fq. 3.*

Në këtë artikull kërkohet që Albania e F. Konicës të pushojë polemiken rreth alfabetit të shqipes dhe të pranojë njein nga të dy alfabetet që u aprovuen në Kongresin e Manastirit.

518. — E VERTETA (Pseudonim): Ç'na duhet Gjuha Shqip?. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) April 29, 1909, Mot'i, parë, Vol. I, Nr. 7, fq. 1.*

Kritikohen disa klerikë (muslimanë e të krishtenë) dhe njerëz të tjerë, të cilët nga paditunia a shkaqe të tjera, mohojnë nevojën e mësimt të gjuhës shqipe, tue pëlqye ma tepër mësimin e gjuhëve të hueja.

519. — FJALËTORE e vogël. — *DITURIA, Selanik, 1 Shkurt 1909, Mot'i parë, Nr. 2; fq. 20-21; Nr. 3, fq. 36-37; Nr. 4; fq. 54; Nr. 5, fq. 56.*

Në mungesë të një fjalori praktik dhe me qëllim që të vihen në qarkullim sa ma shumë fjalë shqipe, në 4 numra të kësaj reviste botohen 165 fjalë shqipe me përkthimin turqisht, frangjisht e greqisht. (Në një shënim thuhet se këto fjalë shumica janë marrë nga autorët e maparshëm dhe vetëm një pakicë janë çpikun nga autori i fjalorthit). (Shkrue me alf. e "Stambollit").

520. — FJALËTORE e vogëlë. E fjalëvet shqip që s'para dihenë. — *KALENDARI KOMBINAR, Selanik, 1909, Mot'i tre-mbëdhjetë, fq. 55-60.*

Botohen 155 fjalë shqipe me përkthimin turqisht, frangjisht dhe greqisht. (Shkrue me alf. e "Stambollit")

521. — FJALËTORETE shqip. — *DITURIJA, 1 Prill 1909, Mot'i parë, Nr. 4, fq. 55-56.*

Deri sa të dalë një fjalor i plotë i gjuhës shqipe, u rekomandohet atyne që duen të mësojnë shqipen këta fjalorë: 1) *Fjalori i Bashkimit* (1908), 2) *Fjalori i Jungut* (1895), 3) *Fjalori i Kristoforidhit* (1904), 4) *Fjalori i Fr. Rossit* (1866), 5) *Fjalori i G. Majerit* (1891), 6) *Fjalori i Hahnit* (Pjesa e III e *Alb. Stud.*) (1854), 7) *Fjalorthi i Dozonit* (në *Man. de la lang. Chkipe*) (1879), 8) *Fjalori i Bardhit* (1635), 9) *Fjalorthi i L. Grudës* (1906). Për të gjithë këta fjalorë jepen të dhana të plota dhe shënime të përgjithëshme. *

522. — FJALORI Shoqërisë "Bashkimi". — *RRUFËJA, Tubhar-Fayoum, H. Egypte Mv 1909, Mot'i I, Nr. 2, fq. 4.*

Njoftim për daljen e Fjalorit të Bashkimit.

523. — GJUHA shqyp dhe shkronjësit e sajël. — *SHQYPËJA Ë SHQYPËNIS, Sofië, 5 të Shënëndreut, 1909, Mot'i par, Nr. 13, fq.2; Nr. 14, fq. 2-3, [Nr. 15, mungon]; 1910, Nr. 16, fq. 3; Nr. 18, fq. 2-3.*

Gjatë kritikës gjuhësore që i bahen disa artikujve të botuem në gaz. *Lirija*, të Selanikut, Autori prek edhe çeshtje të alfabetit, të ortografisë, të leksikut dhe të gjuhës letrare të përbashkët të shqipes. Në këtë artikull (Nr. 16, fq. 3), jepen edhe disa mendime të Naim Frashërit mbi gjuhën shqipe.

524. — IL CONGRESSO Albanese di Elbassan [Kongresi Shqiptar i Elbasanit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Settembre 1909, Anno XIII, Nr. 18, fq. 1.*

Jepen lajme mbi zhvillimin e punimeve të Kongresit të Elbasanit; botohen vendimet e këtij Kongresi (prej 15 pikash). Në p'kën 11 të vendimit shkrintarët porositen të shkruenjë në dialektin e Elbasanit

525. — INFORMAZIONI: Il mese dei Congressi nei Balcani [Mueji i kongreseve në Ballkanet]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro), Italia 15 Settembre 1909, Anno XIII, Nr. 17, fq.6.*

Jepen lajme mbi Kongresin e Elbasanit, informatë e nxjerrë nga *Journal de Salonique* e 5 shtatorit.

526. — KADIU, D.A.: Dy filo-shqiptarë të dëgjuarë në Shqipëri. — *LIDHJA ORTHODHOKSE, Korçë 31 Gusht 1909, Mot'i parë, Nr.4, fq.1.*

Flitet për ardhjen e albanologut Dr. Gustav Vajgandit (Weigand) në Shqipëri (Shih edhe Nr.559). (Shkrue me alf. e "Stambollit").

527. — KLUBI "Bashkim". — *BESA; Konstantinople, 11 Kollozhek 1909, Vit'i parë, Nr. 9, fq.2.*

Njoftohet se Klubi "Bashkimi" këtu, shtypi 20.000 abetare me shkronjat e Kongresit të Manastirit; gjithashtu u çel edhe një shkollë shqipe me mësues z.Cile Vreton. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

528. — KOHETORE. — *ALBANIA, London 1909, vell.XII, Nr.1, fq.33.*

Njoftohet se në Elbasan e hap një klub i ri me emnin "Vëllaznia", i cili ka për qëllim të përhapunit e gjuhës shqipe, etj.

529. — KONGRESI i Elbasanit. — *LIRIJA, Selanik, 12 vjeshtë parë 1909, Mot'i dytë, Nr. 58, fq.1-2.*

Botohen kronika dhe vendimet e këtij Kongresi. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

530. — KONGRESI në Elbasan. — *SHQYPËJA E SHQYPËNIS, Sofië 21 vjesht'e 1-rë 1909*¹
Mot'i par, Nr, 8, fq. 3.

Botohen të dhana mbi punimet e Kongresit dhe qëndrimi i këtij organi ndaj Kongresit të Elbasanit.

531. — KONGRES'i Manastirit. — *DITURIJA, Selanik, 1 Mars 1909, Mot'i parë, Nr.3, fq.41.*

Njoftohet se në Kongresin e Abeces, që u mbajt në Manastir prej 1 deri me 10 vjesht'e tretë (nandor) 1908, kanë marrë pjesë 32 delegatë të ardhun nga 32 shoqni e qytete. Në fq. 40 riprodhohet: 1) një *facsimile* e "Vendimit të Komisionit mbi çështjen e abecesë" (Manastir 7-20 Vjesht'e tretë 1908), 2) Fotografia e pjesëmarrësve të Kongresit (me emnat e tyre), 3) fotografia e Komisionit të alfabetit (me emnat e anëtarëve). (Shkrue me alf. e "Stambollit").

532. — KONGRESI i Manastirit. — *KALENDARI KOMBIAR, Selanik, 1909, Mot'i tre-mbëdhjetë, fq.34.*

Përmbledhje e shkurtën mbi punimet e Kongresit. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

533. — [KONICA, FAIK] : Fleta e Drëqtorit. — *ALBANIA, London 1909, vell. 12, Nr.1-fq.5.*

Shënime kundër Kongresit të Manastirit.

534 — [KONICA, FAIK] : Kongresi i Shqiptarëve Xhon-Turq Ne Maqedhonia. — *ALBANIA; London 1909, vell.12, Nr. 1, fq.24-33.*

A. shkruen për themelimin në Shkodër të Shoq. "Bashkimi" dhe "Agimi" dhe shkaqet e përgamjes së tyre. Citon disa mendime të shprehura nga H.Pedersen i për çështjen e alfabetit të shqipes. Së fundi merret me praktikën dhe rezultatet e Kongresit të Manastirit, tue mbajtë një qëndrim të kundërt dhe kritikues.

535. — [KONICA, FAIK] : Nota Letrare. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) December 3, 1909, Mot'i parë, Vol.1, Nr.36, fq.2.*

1. Botohen disa radhë të letrës së Holger Pedersenit dërgue F.Konicës. Pedersen i shkruen se nuk asht i një mendjeje me artikullin e F.Konicës botue në *Albania* (shih Nr. 534) në lidhje me alfabetin shqip dhe Kongresin e Manastirit. Vendimet e Kongresit të Manastirit për çështjen e alfabetit, Pedersen i konsideron si një përparim shumë i madh, për të cilin duhet urue kombi shqiptar. Vrejttjet e Konicës lidhun me shkronjat ë, gj dhe nj Pedersen i gjen me vend.

2. Çështje ortografie. Autori shkruen se emnat e kombësive kur përdoren si substantiva duhet të shkruhen me të madhë (*Shqiptar*), si adjektiva me të vogël (*shqiptar*).

536. — KONSTANDIN Kristoforidhi. — *KALENDARI "AFËRDITA" për Motin 1910, Manastir 1909, fq.97-98.*

Jepet një skicë biografike e Kristoforidhit. Kritikohet Z.Hariton, i ngarkuem me botimin e fjalorit të Krist., i cili në vënd që ta ndreqte, me padituninë e tij e ka prishun. (Botohet edhe një fotografi e Kr.)

537. — LIBERA shqip. — *KALENDARI KOMBIAR, Selanik 1909, Mot'i tre-mbëdhjetë, fq.36*

Ndër të tjera, edhe : 1. *Grammatik der albanesischen Sprache* të Gj.Pekmezit, me një shënim të shkurtën. (Shkrue me alf. e "Stambollit")

538. — LORECCHIO, ANSELMO : Congresso Albanese a Dibra [Kongres Shqiptar në Dibër]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Agosto 1909, Anno XIII, Nr.15, fq.1-4.*
Riprodhohet në italisht një artikull i botuem në *Journal de Salonique* kushtue Kongresit të Dibrës. Përsa i përket çeshtjes së gjuhës dhe të alfabetit të shqipes në polemikën midis arabistëve dhe latinistëve, në Kongres u vendos që të libet i lirë secili të zgjedhë alfabetin që i pëlqen ma tepër. Ma poshtë botohet teksti i plotë i rezolutës së këtij Kongresi si dhe qëndrimi i A.Lorekjos ndaj këtyne ngjarjeve.
539. — LORECCHIO, ANSELMO : II Congresso linguistico Albanese in Elbassan [Kongresi gjuhësor shqiptar në Elbasan]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Ottobre 1909, Anno XIII, Nr.19, fq.1-2.*
Iniciativa e marrun në Kongresin e parë gjuhësor, që u mbajt në Koriljano Kalabro më 1895, nën kryesinë e De Radës, e ndjekun edhe nga kongreset e mavonëshme për përhapjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, shkruen A., e gjeti shprehjen e vet ma të naltë në këtë kongres të Elbasanit.
540. — LORECCHIO, ANSELMO : La lingua albanese e i "Giovani Turchi" [Gjuha shqipe dhe "Turqit e Rij"]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 febbraio 1909, Anno XIII, Nr.3, fq.1-4.*
Tue u nisë edhe nga dy artikuj të gaz. *Lirija* të Selanikut mbi çeshtjen e gjuhës shqipe, A. në këtë artikull shprehet kundër xhon-turqve, të cilët shkelën premtimin e dhanë për lirinë e mësimin të gjuhës shqipe.
541. — LUMO SKENDO (Pseud. i *Mid'hat Frashërit*) : Istori e shkrimit shqip. — *DITURIJA Selanik, 1 Janar 1909, Mot'i parë, Nr.1 fq. 1-6.*
Historinë e shkrimit shqip A. e nis me veprën e Pjetër Budit "Pasqyra e të Rrëfyemit" (1624) dhe vijon deri te Autorët e Rilindjes. (Shkrue me alf. e "Stambollit").
542. — LUMO SKENDO (Pseud. i *Mid'hat Frashërit*) : Të vëmë re kur shkrojmë. — *DITURIJA, Selanik 1 Shkurt 1909, Mot'i parë, Nr.2, fq.17-19; Nr. 4, fq. 52-53; Nr.7, fq.100-101.*
Çeshtje ortografie. A. sjell shembuj se si duhen shkruen pa gabime pjesë të ndryshme të ligjeratës, rekomandon të studjohen gramatikat e autorëve shqiptarë, etj. (Shkrue me alf. e "Stambollit").
543. — MARIMANGA përsëri zû të endine për me zân doj mîz që të unshehet !. . — *SHQY-PEJA E SHQYPËNIS, Sofië, 21 të Shënëndreut 1909, Mot'i par, Nr.14, fq.1-2.*
Kryeartikull kundër disa personave, që kërkojnë të shkruhet shqipja me shkronja arabe.
544. — NDRYSHIMET e Abëse se Ré. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) February 15, 1909 Mot 'i parë, Vol, 1, Nr.1 ; fq.4.*
Tue fillue nga Nr.3 i këtij organi, Red.njofton se do të përdorë alfabetin latin të aprovuem në Kongresin e Manastirit (Riprodhohet një pasqyrë me ndryshimet e 11 shkronjave të alf. "Bashkimi" me ato të Kongresit).
545. — NJE I KRISHTERË NA FRASHËRI (Pseudonim) : Gjuha Shqip me shkronja greqisht. — *LIRIJA, Selanik 21 Shkurt 1909, Mot'i parë, Nr.30, fq, 3-*

- Artikull kundër disave që duen të nxjerrin në Selanik një gazetë shqipe me shkronja greke. (Shkrue me alf. e "Stambollit")
546. — NJË SHQIPTAR (Pseudonim) : Shkronjat shqip. — *BESA, Konstantinople, 11 Kollozhek 1909, Vit'i parë, Nr.9, fq.1.*
- Artikull kundër deputetit të Sinopit, të quejtun doktor Riza Nuri beu, i cili ka shkruar që shqipja duhet të përdorë shkronjat turke. (Shkrue me alf. e "Stambollit").
547. — PALUCA, N. : Libër i ri. — *BESA, Konstantinople, 26 Kollozhek 1909, Vit' i parë Nr.11, fq.2.*
- Artikull recensiv mbi *Gramatikën e gjuhës shqipe të Dr. Gjergj Pekmezit.* (Shkrue me alf. e "Stambollit").
548. — PANARITI, F. : Gjuha shqip dhe vleft'e saj për Shqiptarët. — *KORÇA, Korçë 20 mars 1909, Vit'i I rë, Nr.8, fq.2.*
- Artikull kundër shkronjave turke dhe në favor të alfabetit të "Stambollit". (Shkrue me alf. e "Stambollit").
549. — PRISHTINA, TEFIK : Leter Zotëni Dreqtor i Gazetës "Besa". — *BESA, Konstantinople, 21 (Shkurt) 1909, Vit'i parë, Nr.13, fq.1-2.*
- Artikull kundër mbrojtësve të alfabetit turk për gjuhën shqipe.. (Shkrue me alf. e "Stambollit").
550. — PROODEUTIKOS (Pseudonim) : Alvanikoi kai Alvanistai. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) October 15, 1909, Mot'i parë, Vol.I, Nr 29 fq.2-3.*
- Botohet një përmbledhje e artikullit me të njejtin titull, botue në gaz.greke *Atlantis* të Nju Jorkut. Autori i këtij artikulli kërkon ta lidhë shqipen me gjuhën greke. *DIELLI* i përgjigjet tue i hedhë poshtë pohimet e Proodeutikosit.
551. — SHKAM'I LETANIT (Pseudo. i *Simon Shuteriqit*) : Kostandin Kristoforidhi. — *KALENDARI "AFËRDITA" për motin 1910, Manastir 1909, fq.122-126.*
- Artikull biobibliografik.
552. — SHKAM'I LETANIT (Pseud. i *Simon Shuteriqit*) : Kongres'i Elbasanit. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) October 8, 1909, Mot'i parë, Vol.I, Nr.28, fq.1.*
- Kronikë e hollësishme mbi punimet e Kongresit të Elbasanit.
553. — SHKRIM'i Shqipesë. — *LIRIJA, Selanik, 24 Janar 1909, Mot'i parë, Nr.26, fq.2.*
- Simbas disa gazetave të Stambollit, mësohet se deputeti Zia Nuri beu, botoi një artikull në *Jeni Gazeta*, ku thotë se shqiptarët duhet të përdorin shkronjat turke. *LIRIJA* porositë bashkatdhetarët të ruhen nga këto mashtrime. (Shkrue me alf. e "Stambollit").
554. — SHKRIMI shqip në kohërat'e vjetra. — *KALENDARI "AFËRDITA" për motin 1910, Manastir 1909, fq.126-129.*
- Botohet një shkrim i Eqrem Vlorës mbi alfabetin e zbuluem në Elbasan prej Dr.Hahnit (alfabeti i njohun sot me emnin e Todrit). Ribotohet një pasqyrë e plotë e këtij alfabeti me versionin shqip (simbas alfabetit të sotëm) dhe turqisht.
555. — SHKRONJAT Shqip. — *LIRIJA, Selanik, 28 Shkurt 1909, Mot'i parë, Nr.31, fq.1.*
- Artikull kushtue mbrojtjes së alfabetit të shqipes kundër shkronjave turke. (Shkrue me alf. e "Stambollit").
556. — SHKRONJAT turqisht. — *LIRIJA, Selanik 14 Shkurt 1909, Mot'i parë Nr.29, fq.3.*
- Shkruhet se doktor Daud nga Musulli, botoi në Stamboll një libërth turqisht me titull : *Islahi hurufa dair meclis-i meb-usana lajiha* (Shkresë mbledhjes së kombit për ndërtim të shkronjave) fq.55. Me qenë se shkronjat turke (arabe), shkruen A., nuk janë

të përshtatshëm për të mësue lehtë e shpejt gjuhën turke, në fq. 52 propozon që për gjuhën turke të përdoret alfabeti i shqipësisë (ai i shoq.Stambollit) si ma i përshtatshëm dhe ma i lehtë për t'u mësue. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

557. — SHOQËRIA "Scanderbeg" në Buenos Aires. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) September 10, 1909, Mot'i parë, Vol.I, Nr.21, fq.3.*

Njoftohet se në Buenos Aires (Argjentinë) u themelue Shoqnia "Scanderbeg", me kryetar Fehim Hoxhën. Në programin e kësaj shoqnie figuron edhe mësimi i shkrimit dhe i këndimit të gjuhës shqipe.

558. — SHPATA (Pseudonim): Gjuha Shqip. — *KALENDARI "AFËRDITA" për motin 1910, Manastir 1909, fq.91-95.*

Preken shkurt çeshtje të alfabetit, të ortografisë, të neologjizimeve dhe të gjuhës letrare të përbashkët të shqipësisë.

559. — TOMORI § D.A.KADIU: Dr.Gustav Weigand. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) September 17, 1909, Mot'i parë, Vol.I, Nr.25, fq.2.*

Njoftohet mbërritja në Durrës e albanologut Dr.Gustav Vajgandit, profesor i Universitetit të Leipzigut. Në një bisedë të mbajtur në gjuhën shqipe me autorin e këtij artikulli, Vajgandi thotë se nuk asht hera e parë që vjen në Shqipëri. 20 vjet ma parë pat vizitue Elbasanin dhe Korçën. Qëllimin e kësaj vizite në Shqipëri, Vajgandi e lidh me nevojën që të mësojë ma për së afërmi nga goja e popullit gjuhën shqipe, e cila paraqet interes për filologjinë dhe historinë e botës. Vajgandi përfundon se në Shqipëri do të qëndrojnë disa muej dhe se do të vizitojë një varg krahinash.

560. — VENDIMET e Kongresit të Elbasanit. — *KORÇA, Korçë 14 Gusht 1909, Vit'i I rë, Nr.13, fq.2.*

Botohen vendimet e Kongresit të Elbasanit. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

561. — VENDIMI i Kongresit të Manastirit Për Abëçenë me një shenim të vogël. — *BASHKIM'I KOMBIT, Manastir 24 vjeshtë Irë 1909, Vit'i I, Nr.3, fq.1.*

Me qenë se Kongresi i Manastirit vendosi të përdoren dy alfabetet (i "Stambollit" dhe ai thjesht latin), Red. e kësaj gazete njofton se në këtë organ do të përdoren të dy alfabetet (nga një herë edhe të përzim). Ribotohen të plotë të dy alfabetet si dhe emnat e nënshkruesve të vendimit të këtij Kongresi. (Shkrue me alf. e "Stambollit").

562. — [ZANONI, ANTON]: Nji shikjim i giuhës shqype. — *ELCIA I ZEMERS JEZU KRISCTIT, Shkodër, Tetuer 1909, Pjesa II, Nr.X, fq.156.*

Fjalori Etimologjik i G.Majerit, përsa i përket numrit të fjalëve; shkruen autori nuk asht i plotë. Kjo shpjegohet nga fakti se G.Majeri asht mbështetur ma tepër në gjuhën e librave se sa në leksikonin e gojës së popullit. Për pasojë shqipja ka shumë, ma tepër fjalë se sa regjistron ky fjalor. Në lidhje me fjalët e hueja që kanë hymë në shqipet, A. shkruen se këto nuk duhet të hiqen të gjitha, po vetëm ato të panevojshmet.

